



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Perandori Justinian p.n., Prishtinë/a, Kosovë/o  
T: +381 (0)38 220 104/5; F: +381 (0)38 220 112; E: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)

KABINETI I KRYETARIT/URED PREDSEDNIKA /CABINET OF THE PRESIDENT

Datë: 7 Qershor 2010  
Ref. Nr. KK 107/10

I nderuari Kryetar,

Gjykata Kushtetuese dëshiron t'ia tërheqë vëmendjen komunës së Prizrenit lidhur me Aktgjykimin e saj në lidhje me Rastin nr. KO 01/09, Xhemajl Kurtishi kundër kuvendit komunal të Prizrenit, të 18 marsit 2010.

Gjykata në veçanti i referohet paragrafit 4 dhe 5 të Aktgjykimit, ku thuhej që Gjykata Kushtetuese:

4. **Urdhëron** komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij Aktgjykimi, ta ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj në mënyrë që ta sjellë atë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos i përjashtojë komunitetet joshumicë;

5. **Kërkon** nga komuna e Prizrenit t'i raportojë Gjykatës mbi përparimin në lidhje me pajtueshmërinë me atë Urdhër, para skadimit të periudhës së tre muajve prej dorëzimit të këtij Aktgjykimi; dhe

6. **Mbetet** e angazhuar fuqimisht për çështjen në pritje të pajtueshmërisë me atë Urdhër.

Gjykata gjithashtu shprehu mendimin në paragrafin 54 të Aktgjykimit se propozimi i z. Kurteshi për t'i pasur fjalët "Komuna", "Opstina" dhe "Belediye" brenda rrethit të emblemës ishte i arsyeshëm. Gjykata kurrë nuk ka thënë që imazhi i Shtëpisë së Lidhjes së Prizrenit ishte objekt i diskutimit.

Koha e dhënë nga Gjykata për ndërrimin e statutit dhe emblemës skadon më 18 qershor 2010. Prandaj, Gjykata Kushtetuese e fton komunën që ta informojë atë lidhur me hapat e ndërmarrë dhe përparimin e bërë për t'u pajtuar me Aktgjykimin e Gjykatës në mbështetje të obligimeve nën nenin 116.1 të Kushtetutës.

Me respekt,

Kryetar  
Prof. Dr. Enver Hasani

